Rezultatet e pritshme	Rritja e përfitimit bujqësor për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme në këtë sektor, përmirësimin dhe specializimin e prodhimit të ushqimit bujqësor.
Interesa publike Interesa private	Mundësi për të ardhura dhe punësim për banorët vendas. Këto qendra mund të menaxhohen nga Bashkia ose nga konsorciumet e operatorëve privatë.
Vlera e projektit	Për tu vlerësuar.
Burime të mundshme financimi	Bashkia, Agjencitë për zhvillim ndërkombëtar.
Projekte të ngjashme	
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme	
Prioriteti	Raporti me Axhendën e OKB-së 2030: Objektivi 8. Nxitja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë Objektivi 9. Ndërtimi I një infrastrukturës elastike dhe promovimi i inovacionit dhe industrializimit të barabartë, të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshëm të prodhimit dhe konsumit



5.1.1 Realizimi i qendrave agro-ushqimore në bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.1	PROGRAMI	STRUKTURAT E SHËRBIMIT
5.1.2	EMËRTIMI I PROJEKTIT	TREG PRODHIMESH TIPIKE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE ME KM ZERO
Përshkrimi i projektit		Projekti synon të promovojë dhe mbështesë bashkëpunimin ndërmjet sipërmarrjeve sipas një logjike territori përmes realizimit të kontratave të investimeve për ndërtimin dhe fuqizimin e micro-zinxhirëve (filierave) të prodhimit vendor në kuadër të Projekteve Vendore të Zhvillimit, përfituesit e të cilëve janë sipërmarrjet dhe konsorciumet e tyre. Parashikohet ndërtimi i një zone tregtare, në të cilën prodhuesit do të kenë një hapësirë për shitje direkte, informacion për konsumatorët, projekte për rimëkëmbje / ripërdorimin, me një përballje të vazhdueshme me nevojat dhe shijet e tyre. Sipërfaqja e ndërtuar dhe menaxhuar nga një konsorcium sipërmarrjesh, përmes rinovimit të një strukture ekzistuese apo realizimit të një çadre ose kapanoni të ngjashëm me ato industriale. Duhet parashikuar një zonë e dedikuar posaçërisht për shitjen dhe një zonë tjetër për magazinimin e mallrave. Duhet parashikuar gjithashtu një hapësirë për të mbledhur mbeturinat nga përpunimi i produkteve ushqimore dhe të mbledhjes së vajit të përdorur për t'i dhënë atyre një jetë të re. Së fundmi, duhet parashikuar një hapësirë zyrash për promovimin dhe shitjen e produkteve jashtë zonës Urbane. Zona e tregut do të jetë e hapur si për produktet ushqimore, ashtu edhe për ato jo-ushqimore, për aq kohë sa, në rastin e fundit, bëhet fjalë për produkte tipike
Rezultatet e pritshme		Rritja e produktivitetit bujqësor të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në këtë sektor, përmirësimi dhe specializimi i prodhimeve ushqimore bujqësore
Interesa publike Interesa private		Mundësi për të ardhura dhe punësim për popullsinë vendase Këto qendra mund të menaxhohen nga bashkitë ose nga konsorciume të operatorëve privatë.
Vlera e projektit		Për tu vlerësuar.
Burime të mundshme financimi		Bashkia, Agjencitë e zhvillimit ndërkombëtar
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		
Prioriteti		Afatmesëm - Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 8. Nxitja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin



5.1.2 Zona tregtare me prodhime me km zero

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.1	PROGRAMI	STRUKTURAT E SHËRBIMIT
5.1.3	EMËRTIMI I PROJEKTIT	PËRMIRËSIM DHE ZHVILLIM I RRJETIT TË KANALEVE UJITËSE DHE KULLUESE NE ZONAT FUSHORE SI DHE MASAT KUNDËR EROZIONIT DHE PËRMBYTJEVE NE ZONAT MALORE
Përshkrimi i projektit		Kanalet e Para janë në varësi të shtetit (bordit të kullimit), këto varen nga planifikimi i ministrisë së bujqësisë. Kanalet e Treta janë në varësi të fermerëve. Bashkia duhet të vendosë sanksione ndaj fermerëve që nuk zbatojnë këtë detyrë. Ka edhe një mundësi të dytë për ata fermerë që nuk kanë mundësi të realizojnë vetë pastrimin dhe mirëmbajtjen e Kanaleve të Treta që t'ia delegojnë bashkisë nëpërmjet pagesës me çmim kostoje. Gjithashtu me shumë rëndësi është detyra e bashkisë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e Kanaleve të Dyta ujitëse dhe kulluese që kanë një volum të madh e që si rregull duhen pastruar 1 herë ne 3-4 vite (sipas zonës). Projekti parashikon organizimin e strukturave të bashkisë që të merren me mirëmbajtjen e vazhdueshme të këtyre kanaleve, edhe me ane të investimeve ne mjete dhe logjistikë. Brenda këtij kuadri duhet të studiohen në veçanti disa ndërhyrje anti-erozive në zonat Shllak e Temal dhe disa masa anti-përmbytje në njësinë administrative Vig-Mnelë.
Rezultatet e pritshme		Reduktimi i rrezikut hidrogjeologjik, efikasitet më i madh i rrjeteve ujore.
Interesi publik		Të ardhura më të larta në bashki. Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori.
Vlera e projektit		Sipas tarifave të bordit të kullimit ,1 m³ gërmim kushton 235 lekë nëse kryhet me të tretë, pra 705000 lekë/km. Afërsisht 20-22 milionë lekë për 30 km. Në rast se volumet kryhen me mjetet në pronësi të Bashkisë, kostoja është rreth 50% më e ulët, pra rreth 10 milionë lekë për 30 km.
Burime të mundshme financimi		Bashkia, agjencitë e zhvillimit ndërkombëtar
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		
Prioriteti		Afatmesëm - Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 8. Nxitja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin.



5.1.3 Përmirësim dhe zhvillim i rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese ne zonat fushore si dhe masat kundër erozionit dhe përmbytjeve ne zonat malore.

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.1	PROGRAMI	STRUKTURAT E SHËRBIMIT
5.1.4	EMËRTIMI I PROJEKTIT	ORGANIZIMI I DEGËS SË PRODHIMIT BUJQËSOR DHE BLEGTORAL PRANË BASHKISË.
Përshkrimi i projektit		Drejtimi kryesor i zhvillimit të bashkisë Vau-Dejës është prodhimi bujqësorë dhe blegtoral, për këtë arsye shumica e investimeve dhe shpenzimeve operative duhet te orientohen në këtë drejtim. Si fillim lind nevoja e ngritjes së degës së prodhimit dhe nuk duhet lënë asnjë njësi administrative e pambuluar nga një agronom dhe një veteriner. Njësia Vau-Dejës duhet të mbulohet nga agronomi i degës së prodhimit bujqësor si dhe një veteriner. Njësia Hajmel dhe njësia Vig-Mnelë duhet të mbulohen nga një agronom dhe një veteriner me qendër në Hajmel. Njësia Bushat duhet të mbulohet nga një agronom dhe një veteriner me qendër në Bushat. Njësitë Shllak dhe Temal duhet të mbulohen nga një agronom dhe një veteriner me qendër në Shllak. Qendra e degës së prodhimit bujqësorë të jetë në zyrat e njësisë administrative Bushat, ku ndodhet 60-70% e prodhimit dhe kushtet e akomodimit janë më të favorshme. Në vija të përgjithshme, shpenzimi vjetor për këta 8 specialistë mund të jetë rreth 8 milionë lekë (pagë bruto). Detyrat kryesore të tyre do të jenë ndjekja dhe këshillimi i banoreve në lidhje me proceset bujqësore dhe blegtorale dhe azhornimi i bazës së të dhënave të bashkisë në lidhje me bujqësinë dhe blegtorinë.
Rezultatet e pritshme		Përmirësim i sasisë dhe cilësisë së prodhimit; Rritja e numrit te ndërmarrjeve bujqësore dhe blegtorale; Përmirësimi i strategjive vendore në sajë të të dhënave më të sakta të sektorit.
Interesi publik Interesi privat		Efiçencë më e madhe në veprimet administrative të sektorit; Rritje e te ardhurave te bashkisë nga aktivitet bujqesore dhe blegtorale. Mbështetja e sektorit ekonomik agroushqimor.
Vlera e projektit		Në përgjithësi, shpenzimi vjetor për këta tetë specialistë mund të jetë rreth 8 milionë (rroga bruto).
Burime të mundshme financimi		Bashkia
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		
Prioriteti		Afatmesëm - Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030. Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin.

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.1	PROGRAMI	STRUKTURAT E SHËRBIMIT
5.1.5	EMËRTIMI I PROJEKTIT	NXITJA E SHOQËRIZIMIT TË PUNËS, DOMOSDOSHMËRI PËR RRITJEN E PRODHIMIT BUJQËSOR
Përshkrimi i projektit	Këshilli bashkiak duhet të miratojë politika stimuluese për të nxitur shoqërizimin e punës ndërmjet fermerëve dhe blegtorëve, brenda kompetencave ligjore. Ky shoqërizim mund të fillojë me sukses me perimet (sidomos në sera), në sektorin e vreshtarisë dhe në blegtori (duke shfrytëzuar ndërtesa ekzistuese), në bimë arash, etj. Synimi duhet të jetë që të bëhet e mundur që në çdo njësi administrative të ngrihen 1 ose 2 “shoqëri prodhuese”, të cilat do të jenë nën kujdesin e vazhdueshëm të specialistit përkatës. Stimujt mund të jenë të ndryshëm ,duke filluar që nga lehtësimi nga taksat apo tarifat deri në subvencionimin e mallit të shitur në masën e 10-15%.	
Rezultatet e pritshme	Përmirësimi i konkurrencës së sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme lokale të sektorit agroushqimor.	
Interesi publik Interesi privat	Të ardhura më të mëdha për bashkinë. Mundësi të ardhurash, përfitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori.	
Vlera e projektit	Për tu vlerësuar.	
Burime të mundshme financimi	Bashkia, agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit.	
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		
Prioriteti	Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin	

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.1	PROGRAMI	STRUKTURAT E SHËRBIMIT
5.1.6	EMËRTIMI I PROJEKTIT	QENDËR PËRPUNIMI ,STANDARDIZIMI, MAGAZINIMI PËR GËSHTENJËN DHE ETEROVAJORET NË SHLLAK DHE TEMAL
Përshkrimi i projektit		Sipërfaqja prej 300 Ha gështenja dhe sasitë e konsiderueshme të sherbelës dhe timusit natyral të zonës bëjnë të domosdoshme ngritjen e kësaj qendre. Modeli ekziston në njësinë Reç të bashkisë Shkodër. Ato kanë vite që funksionojnë si shoqatë dhe kanë rezultate pozitive. Një qendër e tillë mund të ngrihet nga vetë bashkia e cila mund të marrë përsipër menaxhimin e saj me sistem kontratash. Më mirë do të ishte që një sipërmarrës të ndihmohet nëpërmjet projekteve të ndryshme të Ministrisë së Bujqësisë, të ngrejë këtë qendër dhe të ketë detyrë kontraktimin e prodhimit çdo fillim viti.
Rezultatet e pritshme		Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme vendore të sektorit agroushqimor, pyjor dhe blegtoral.
Interesi publik Interesi privat		Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, përfitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori
Vlera e projektit		Bazuar në punën e Qendrës Rec në Bashkinë Shkodër, një depo 200 m², me strukturë të lehtë, e pajisur me makineri të nevojshme, mund të kushtojë rreth 7-8 milionë euro. (ose "të vlerësohet pas studimit të bështmërisë (fizibilitetit)").
Burime të mundshme financimi		Bashkia, ndërmarrjet agro-pyjore private.
Projekte të ngjashme		Ekziston një model i njësisë Rec në Bashkinë Shkodër.
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave Ministria e Ekonomisë Ministria e Mjedisit
Prioriteti		Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin.



5.1.6 Qendër përpunimi ,standardizimi, magazinimi për gështenjën dhe eterovajoret ne Shllak dhe Temal.



5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.2	PROGRAMI	RRITJA E PRODHIMTARISË
5.2.1	EMËRTIMI I PROJEKTIT	ZHVILLIMI I KULTIVIMIT TË ORIZIT NË FSHATRAT BARBULLUSH, KUKËL DHE DHEU I LEHTË
Përshkrimi i projektit	Kjo është një kulturë ne te cilën mund të shoqërizohet me shumë sukses si toka edhe puna. Kultivimi i kësaj kulture është traditë e këtyre zonave, është i garantuar uji, orizi mund të mbillet në kohë dhe nuk janë zona të përmbytura.	
Rezultatet e pritshme	Zhvillimi i punësimit në fushën e bujqësisë, Përmirësimi i konkurrencës së sipërmarrjeve të mesme dhe të vogla të sektorit agroushqimor. Mbetet për t'u verifikuar tregu.	
Interesi publik Interesi privat	Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, përfitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori	
Vlera e projektit	Për tu vlerësuar.	
Burime të mundshme financimi	Bashkia, ndërmarrjet bujqësore private	
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	
Prioriteti	Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin	



5.2.1 Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehte

5	**OBJEKTIVI**	**BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT**
5.2	**PROGRAMI**	**STRUKTURAT E SHËRBIMIT**
5.2.2	**EMËRTIMI I PROJEKTIT**	**ZHVILLIMI I KOMPLEKSEVE BLEGTORALE NË BUSHAT DHE VAU-DEJËS**

Përshkrimi i projektit	Zhvillimi i dy ndërmarrjeve blegtorale të njësive Bushat e Vau-Dejës
Rezultatet e pritshme	Zhvillimi i punësimit në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, rritja e përmirësimit cilësor të prodhimeve të këtij sektori
Interesi publik Interesi privat	Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, përfitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori
Vlera e projektit	Për tu vlerësuar.
Burime të mundshme financimi	Bashkia, ndërmarrjet bujqësore dhe blegtorale private
Projekte të ngjashme	
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
Prioriteti	Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin



5.2.2 Zhvillimi i kompleksëve blegtorale ne Bushat dhe Vau-Dejës

5	**OBJEKTIVI**	**BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT**
5.2	**PROGRAMI**	**RRITJA E PRODHIMTARISË**
5.2.3	**EMËRTIMI I PROJEKTIT**	**ZHVILLIMI I PESHKIMIT DHE REZERVATEVE NË VAU-DEJËS**
Përshkrimi i projektit		"Zhvillimi i njësive të rritjes së peshkut në Vau-Dejës" duke parë potencialin e lartë që paraqet liqeni dhe duke u bazuar në eksperiencat ekzistuese në territor.
Rezultatet e pritshme		Zhvillimi i punësimit në fushën e kultivimit të peshkut, rritja dhe përmirësimi cilësor i prodhimit të këtij sektori.
Interesi publik Interesi privat		Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori
Vlera e projektit		Për tu vlerësuar.
Burime të mundshme financimi		Bashkia, ndërmarrjet private të kultivimit të peshkut
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
Prioriteti		Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin



5.2.3 Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në Vau-Dejë

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.2	PROGRAMI	RRITJA E PRODHIMTARISË
5.2.4	EMËRTIMI I PROJEKTIT	ZHVILLIMI I SERRAVE PËR KOPSHTARINË NË KOSMAÇ DHE NË FSHATRA TË TJERA TË BASHKISË
Përshkrimi i projektit	Kushtet klimatike dhe të tokës favorizojnë shumë kultivimin e perimeve në serë në të gjitha njësitë fushore të bashkisë Vau-Dejës. Duhen lokalizuar disa zona dhe të punohet me fermerët vendas duke i nxitur këto forma biznesi. Nëpërmjet A.ZH.B.R. duhet të përgatiten disa projekte konkurruese për kultivimin e perimeve në sera si dhe këta fermerë duhet të mbështeten me asistencë teknike.	
Rezultatet e pritshme	Zhvillimi dhe shumëllojshmëria e prodhimit bujqësor, rritja e kushteve të punës, të ardhurave dhe fitimit; rritja dhe përmirësimi cilësor i prodhimeve të sektorit.	
Interesi publik Interesi privat	Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori.	
Vlera e projektit	1 hektarë serrë kushton 1 milion lekë	
Burime të mundshme financimi	Bashkia, ndërmarrjet bujqësore private	
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	
Prioriteti	Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin	



5.2.4 Zhvillimi i serave të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë.

5	OBJEKTIVI	BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
5.2	PROGRAMI	RRITJA E PRODHIMTARISË
5.2.5	EMËRTIMI I PROJEKTIT	ZHVILLIMI I BAXHOVE NË HAJMEL DHE VIG-MNELË
Përshkrimi i projektit		Realizimi i një strukture të prodhimit të produkteve të qumështit me funksion eksperimentues të teknikave të prodhimit, konservimit dhe ruajtjes në mbështetje të sipërmarrjeve lokale të sektorit.
Rezultatet e pritshme		Realizimi i një strukture të prodhimit të produkteve të qumështit me funksion eksperimentues të teknikave të prodhimit, konservimit dhe ruajtjes në mbështetje të sipërmarrjeve lokale të sektorit.
Interesi publik Interesi privat		Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori.
Vlera e projektit		Për tu vlerësuar.
Burime të mundshme financimi		Bashkia, sipërmarrjet në këtë sektor.
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
Prioriteti		Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin.



5.2.5 Zhvillimi i baxhove në Hajmel dhe Vig-Mnelë

5	**OBJEKTIVI**	**BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT**
5.2	**PROGRAMI**	**RRITJA E PRODHIMTARISË**
5.2.6	**EMËRTIMI I PROJEKTIT**	**ZHVILLIMI I VRESHTAVE NË HAJMEL ,BUSHAT, VAU-DEJËS, VIG –MNELË**
Përshkrimi i projektit	Programi ka si synim dyfishimin e prodhimit të vreshtarisë në Hajmel, përveç organizimit të strukturave të reja të përpunimit (kantina). Të gjitha këto zona kanë kushte të favorshme për prodhim rrushi. Duhet të lokalizohen ngastrat duke marrë mendimin e fermerëve dhe duke i mbështetur ata me projekte konkurruese sipas mundësive. Sipërfaqet duhet të jenë gjithmonë të grupuara dhe të ketë mundësi instalimi të ujitjes me pika. Investimi është i madh prandaj duhet të programohet për një afat 10 vjeçar, duke pasur parasysh faktin që nga mbjellja deri në futjen në prodhim vreshta kërkon investim rreth 2 milionë lekë/ha. Objektivi duhet të jetë që në këto zona të arrihet një sipërfaqe gjithsej prej 250 ha vreshta, pra të mbillen çdo vit 15 ha	
Rezultatet e pritshme	Kualifikimi i peizazhit bujqësor lokal, në kontrast me degradimin dhe ekspozimit ndaj rrezikut hidrogjeologjik të shpateve në kushtet e paqëndrueshmërisë aktuale ose të mundshme. Zhvillimi dhe shumëllojshmëria e prodhimit lokal të verës, rritja e kushteve të punës, të ardhurave dhe fitimit; Rritja dhe përmirësimi cilësor i prodhimeve të sektorit.	
Interesi publik Interesi privat	Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori	
Vlera e projektit	Duhet të theksohet se nga mbjellja deri në përdorimin e vreshtave për prodhimin, kërkohet një investim prej 2 milion lekë / ha (në Itali rreth 30,000 euro / ha)	
Burime të mundshme financimi	Bashkia, sipërmarrjet private të verës.	
Projekte të ngjashme	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.	
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		
Prioriteti	Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin	



5.2.6 Zhvillimi i vreshtave ne Hajmel ,Bushat, Vau-Dejës, Vig –Mnelë

5	**OBJEKTIVI**	**BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT**
5.2	**PROGRAMI**	**RRITJA E PRODHIMTARISË**
5.2.7	**EMËRTIMI I PROJEKTIT**	**ASISTENCË TEKNIKE E VEÇANTË PART-TIME ME SPECIALISTE TË PROFILIZUAR PËR DY ASETE ME RËNDËSI për bashkinë** **a) Kultivimi i perimeve në serra** **b) Kultivimi dhe teknologjia e përpunimit të rrushit**
Përshkrimi i projektit		Niveli i lartë i teknologjisë që sot përdoret në sera dhe vreshta kërkon nivel më të specializuar teknik sesa ai që ekziston në bashkinë Vau-Dejës. Do të ishte shumë efikase që për dy vite ,dy specialistë të mirëfilltë të këtyre fushave të trajnonin gjatë vitit fermerët duke bërë secili nga rreth 15 takime në vit sipas afateve që do të përcaktojnë ata. Trajnimi duhet të jetë teoriko-praktik në ngastra pilot që do të caktohen nga vetë specialistet dhe duhet te realizohet edhe në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale "Ndre Mjeda" në mënyrë qe këto trajnime të shërbejnë edhe si praktikë për profesionistët e ardhshëm duke u integruar me procesin mësimor.
Rezultatet e pritshme		Përmirësimi i aftësisë drejtuese bujqësore të sipërmarrjeve vendase
Interesi publik Interesi privat		Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori
Vlera e projektit		Fondi i pagave prej 300.000 lekë në vit
Burime të mundshme financimi		Bashkia
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me qendrën e transferimit të teknologjive bujqësore (Shkodër-Fushë Krujë)
Prioriteti		Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin

5	**OBJEKTIVI**	**BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT**
5.2	**PROGRAMI**	**RRITJA E PRODHIMTARISË**
5.2.8	**EMËRTIMI I PROJEKTIT**	**ZBATIMI I PROJEKTIT PËR MBJELLJEN E 150 HA SHEGË NË ZONA KODRINORE, NË 6 FSHATRA ME NGA 25 HA NË BLLOK**
Përshkrimi i projektit		Ky projekt është zhvilluar nga DBU Shkodër në bashkëpunim me K. Q Shkodër si pjesë e planit strategjik të zhvillimit të komunës Hajmel, financuar dhe mbështetur nga komuna Hajmel. Shega është një produkt me kërkesë të lartë për produkte të freskëta dhe të përpunuara. Ideja është që ky projekt të mund të realizohet në kuadrin e 15 vjetëve me një investim prej 10 ha në vit me një kosto prej 5.5 milion lekë në vit.
Rezultatet e pritshme		Kualifikimi i peizazhit bujqësor lokal, në kontrast me degradimin dhe ekspozimin ndaj rrezikut hidrogjeologjik të shpateve në kushtet e paqëndrueshmërisë aktuale ose të mundshme. Zhvillimi dhe shumëllojshmëria e prodhimit të verës vendase, rritja e kushteve të punës, të ardhura dhe fitime; rritja dhe përmirësimi cilësor i prodhimeve të sektorit
Interesi publik Interesi privat		Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori
Vlera e projektit		5,5 milionë lekë për 15 vjet
Burime të mundshme financimi		Bashkia, sipërmarrjet bujqësore private
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
Prioriteti		Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin

5	**OBJEKTIVI**	**BUJQËSIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT**
5.2	**PROGRAMI**	**RRITJA E PRODHIMTARISË**
5.2.9	**EMËRTIMI I PROJEKTIT**	**PARK BLETËSH NË SHLLAK DHE TEMAL**
Përshkrimi i projektit	Zona e Shllakut dhe Temalit është mjaft e favorshme për prodhimin e mjaltit sepse klima lejon kultivimin natyror të shumë kulturave "melifere", duke siguruar kështu lulëzim gjithëvjetor. Ekzistojnë dhjetëra kultura të ndryshme që lulëzojnë gjatë gjithë vitit. Njëkohësisht uji, i domosdoshëm për rritjen e bletëve, është prezent gjithmonë. Synohet të krijohet një "shoqatë bletërritësish" me 10 fermerë, 5 nga Shllaku dhe 5 nga Temali që do të bashkëpunojnë me shoqatën e bletërritësve të Qarkut Shkodër. Fillimisht duhet që bashkia të përzgjedhë 10 fermerë, të cilët trajnohen për 2-3 ditë pranë shkollës së mesme bujqësore Bushat. Pas trajnimit duhet të gjendet mënyra e pajisjes së çdo fermeri me nga dy zgjoje me bletë , duke krijuar një park bletësh fillimisht me këto 20 zgjoj dhe me objektiva të larta për shtimin e tyre. Shpenzimi për blerjen e zgjojeve mund të shkojë 400-500 mijë lekë; ndërsa shpenzimi për trajnim 100000 lekë. Trajnimi do të bëhet nga specialistë shoqate bletërritësish në Shkodër; në total shpenzimi është 600000 lekë.	
Rezultatet e pritshme	Zhvillimi dhe shumëllojshmëria e prodhimeve agroushqimore vendase, rritja e kushteve të punës, të ardhurat dhe fitimet, rritja dhe përmirësimi cilësor i prodhimit në këtë sektor	
Interesi publik Interesi privat	Të ardhura më të mëdha për bashkinë Mundësi të ardhurash, fitimi dhe punësimi për sipërmarrjet e këtij sektori	
Vlera e projektit	Shpenzimi total është 600 000 lekë	
Burime financimi	Bashkia, sipërmarrjet vendase	
Projekte të ngjashme		
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	
Prioriteti	Afatmesëm – Afatgjatë Raporte me Axhendën e OKB-së 2030 Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme për prodhimin dhe konsumin	



5.2.9 Park bletësh në Shllak dhe Temal

6	**OBJEKTIVI**	**ENERGJIA**
6.1	**PROGRAMI**	**ZHVILLIMI I PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA BURIME TË RINOVUESHME**
6.1.1	**EMËRTIMI I PROJEKTIT**	**ZHVILLIMI I IMPIANTEVE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË FOTOVOLTAIKE**
Përshkrimi i projektit		Plani parashikon zhvillimin e iniciativave publike dhe private, edhe përmes tenderit publik për t'i dhënë privatëve me koncesion tokat publike apo pronat shtetërore në gjendje të degraduar dhe që janë jashtë përdorimit, për ndërtimin e impianteve për prodhimin e energjisë nga burime fotovoltaike me përmasa të vogla, të mesme dhe të mëdha për t'u vendosur përkatësisht në strukturat dhe / ose ndërtesat publike dhe private, zona industriale jashtë funksionit, gurore joproduktive, depozitimet e mbetjeve të ngurta urbane dhe zona që rezultojnë jo të përdorshme për bujqësi, në përputhje me cilësi të peizazhit të konteksteve lokale dhe funksioneve bujqësore të mundshme dhe ekzistuese.
Rezultatet e pritshme		Përmirësimi i furnizimit me energji të objekteve publike (shkolla, ndërtesave qeveritare) dhe private (ndërtesa civile dhe rezidenciale); reduktimi i prodhimit të CO2 për prodhimin e energjisë; reduktimin e ndotjes së mjedisit dhe konsumit të burimeve jo të rinovueshme.
Interesa publike Interesa private		Ulja e shpenzimeve të administratës publike, duke hequr kosto të energjisë nga ana e bizneseve dhe familjeve
Vlera e projektit		Për tu vlerësuar.
Burime të mundshme financimi		Bashkia, sektori privat, financimi i projektit, sektori bankar.
Projekte të ngjashme		**Skema e funksionimit të centraleve fotovoltaike**  http://www.eraenergie.com/portfolio/centrale-fotovoltaica-99881-kwp/
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme		Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Ministria e Energjetikës Ministria Mjedisit
Prioriteti		Terma afatmesëm-afatgjatë Raporte me Axhendën OKB 2030 Objektivi 11. Arritja e qyteteve dhe vendbanimeve të njerëzve gjithëpërfshirëse, të sigurta, jetëgjatë dhe të qëndrueshme Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit.

6	**OBJEKTIVI**	**ENERGJIA**
6.1	**PROGRAMI**	**ZHVILLIMI I PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA BURIME TË RINOVUESHME**
6.1.2	**EMËRTIMI I PROJEKTIT**	**ZHVILLIMI I IMPIANTEVE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË SË BIOMASËS**
Përshkrimi i projektit	Plani parashikon zhvillimin e iniciativave private dhe publike për realizimin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga biomasa e mbetjeve të prodhimit bujqësor, ose nga mbetjet prej fermave intensive (biogazi). Këto impiante do të jenë të lokalizuara në afërsi të njësive të prodhimit bujqësor dhe / ose industrial, duke parashikuar edhe shkëmbimin në vend dmth. pa hyrje të energjisë në rrjetin kombëtar.	
Rezultatet e pritshme Risultati attesi	Përmirësimi i efikasitetit dhe pavarësisë energjetike të kompanive të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë	
Interesa publike Interesa private	Reduktimi i kostos së furnizimit me energji të bizneseve të sektorit primar	
Vlera e projektit	Për tu vlerësuar.	
Burime të mundshme financimi	Bashkia, bizneset e sektorit, sektori bankar	
Projekte të ngjashme	 www.regione.piemonte.it/energia/dwd/buonePratiche/buonePratiche_024.pdf	
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Ministria e Energjetikës Ministria Mjedisit	
Prioriteti	Terma afatmesëm-afatgjatë Raporte me Axhendën OKB 2030 Objektivi 11. Arritja e qyteteve dhe vendbanimeve të njerëzve gjithëpërfshirëse, të sigurta, jetëgjatë dhe të qëndrueshme Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit	

6	OBJEKTIVI	ENERGJIA
6.2	PROGRAMI	DIFERENCIMI I PRODHIMIT TË ENERGJISË
6.2.1	EMËRTIMI I PROJEKTIT	MODERNIZIM I LANDFILLIT TË BUSHATIT NËPËRMJET NDËRHYRJEVE PËR RIPËRDORIMIN, RICIKLIMIN, PRODHIMIN E BIOGAZIT DHE PYLLËZIMIN E KURORËS

Përshkrimi i projektit	Projekti parashikon ndërtimin e centraleve me biogaz për prodhimin e energjisë elektrike përmes tretjes anaerobe dhe kompostimin e mbetjeve të ngurta organike dhe të biomasës, që kur kombinohen me mbledhjen e diferencuar të mbetjeve të ngurta urbane do të sillnin një kontribut të rëndësishëm në arritjen e objektivave të Protokollit të Kiotos.
Rezultatet e pritshme	Përmirësimi i efikasitetit dhe pavarësisë energjetike të kompanive të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë
Interesa publike Interesa private	Reduktimi i kostos së furnizimit me energji të bizneseve të sektorit primar
Vlera e projektit	Për tu vlerësuar.
Burime të mundshme financimi	Bashkia, bizneset e sektorit, sektori bankar
Projekte të ngjashme	 www.itctannoia.gov.it/FileJoomla/mat_ruvo/energia.pps http://www.centraledimanfredonia.it/impianto.html
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Ministria Mjedisit
Prioritete	Terma afatmesëm-afatgjatë Raporte me Axhendën ONU 2030 Objektivi 11. Arritja e qyteteve dhe vendbanimeve të njerëzve gjithëpërfshirëse, të sigurta, jetëgjatë dhe të qëndrueshme Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit

6	OBJEKTIVI	ENERGJIA
6.2	PROGRAMI	DIFERENCIMI I PRODHIMIT TË ENERGJISË
6.2.2	EMËRTIMI I PROJEKTIT	PROGRAM PËR NXITJEN E REALIZIMIT TË IMPIANTEVE PËR VETËKONSUM ENERGJETIK
Përshkrimi i projektit	Plani parashikon zbatimin e një programi për nxitjen e rritjes së efiçencës energjetike te objekteve te pasurisë publike dhe atyre te ndërmarrjeve bujqësore dhe industriale si dhe të vetëkonsumit të atyre vendbanimeve dhe vendprodhimeve qe gjenden në zona të vështira për t'u arritur nga infrastruktura. Ky program i bashkuar me teknologjinë e akumulatorëve të energjisë (bateritë litium) mund të lejojë komunitetet qe të bëhet te vetëmjaftueshme në sajë të teknologjive për "magazinimin" dhe menaxhimin e prodhimit dhe kërkesës së ndryshueshme për energji elektrike.	
Rezultatet e pritshme	Përmirësimi i efikasitetit dhe pavarësisë energjetike të kompanive të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë	
Interesa publike Interesa private	Reduktimi i kostos së furnizimit me energji të bizneseve të sektorit primar	
Vlera e projektit	Për tu vlerësuar.	
Burime të mundshme financimi	Bashkia, bizneset e sektorit, sektori bankar	
Projekte të ngjashme	 http://www.ingridproject.eu/index.php?option=com_content&view=article&id=28&Itemid=199	
Institucione që lëshojnë lejet dhe licencat e nevojshme	Ministria Mjedisit	
Prioritete	Terma afatmesëm-afatgjatë Raporte me Axhendën ONU 2030 Objektivi 11. Arritja e qyteteve dhe vendbanimeve të njerëzve gjithëpërfshirëse, të sigurta, jetëgjatë dhe të qëndrueshme Objektivi 12. Garantimi i modeleve të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit	

Axhenda 2030:

Axhenda 2030 për zhvilliminm e qëndrueshëm është një program veprimi për njerzit planet dhe begatinë e nënshkruar në shtator 2015 nga qeveritë e 193 vendeve anëtare të OKB-së. Ajo përfshin 17 objektiva për zhvillim të qëndrueshëm – Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm - në një program të madh të veprimit për një total prej 169 'synime' ose pika. Nisja zyrtare e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm përkoi me fillimin e vitit 2016, duke drejtuar botën në rrugën përpara gjatë 15 viteve të ardhshme: vendet, në fakt, janë zotuar për ti arritur deri në vitin 2030.

Objektivat për zhvillimin ndjekin objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit (Millennium Development Goals) që i paraprinë atyre, dhe janë objektiva të përbashkëta të një sërë çështjesh të rëndësishme për zhvillim: luftën kundër varfërisë, fundin e urisë dhe ndryshimeve e klimatike, për të përmendur vetëm disa. "Objektivat e përbashkëta" do të thotë se ato zbatohen në të gjitha vendet dhe të gjithë individët: askush nuk është i përjashtuar, as nuk duhet të lihet prapa në rrugën e nevojshme për të çuar botën në rrugë të qëndrueshme. (http://www.unric.org/it/images/Agenda_2030_ITA.pdf)

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm:

Objektivi 1: Dhënia fund e varfërisë në të gjitha format e saj;

Objektivi 2: Dhënia fund e urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe ushqimi i përmirësuar dhe përmirësimi i promovimi i bujqësisë së qëndrueshme;

Objektivi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat;

Objektivi 4: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë si dhe promovimi i mundësive të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë;

Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe emancipimi i grave dhe vajzave.

Objektivi 6: Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë;

Objektivi 7: Sigurimi i aksesit për energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë;

Objektivi 8. Nxitja e një rritje ekonomike jetëgjatë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, një punësim i plotë e produktiv dhe një punë të denjë për të gjithë.

Objektivi 9: Ndërtimi i një infrastrukture elastike dhe promovimi i risive dhe një industrializim i drejtë, i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm.

Objektivi 10. Zvogëlimi i pabarazisë brenda dhe ndërmjet kombetve.

Objektivi 11: Bërja e qyteteve dhe e vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirës, të sigurte, jetëgjatë dhe të qëndrueshëm

Objektivi 12: Të garantohet modele të qëndrueshëm prodhimi dhe konsumi.

Objektivi 13: Marrja e veprime urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimin e saj;

Objektivi 14: Konservimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeaneve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm

Objektivi 15: Mbrojtja, rivendosja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshme i pyjeve, luftimi i thatësirës, ndalimi i përmbytjes e degradimin të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit;

Objektivi 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet;

Objektivi 17: Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimit të partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm.